

V E N D I M
Nr. 190, datë 16.4.1993

PËR RIORGANIZIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT

Me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e bordit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, si organ drejtues i kësaj agjencie. Bordi përbëhet nga 11 anëtarë. Kryetari dhe anëtarët caktohen nga kryetari i Këshillit të Ministrave.

2. Anëtarët e bordit drejtues shpërblehen mbi bazën e honorareve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Bordi drejtues mblidhet të paktën 6 herë në vit, por jo më tepër se 12 herë në vit.

4. Bordi drejtues i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, ka këto detyra kryesore:

a) Harton projektstatutin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, të cilin ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

b) Harton politikën dhe strategjinë e privatizimit sipas dispozitave në fuqi të privatizimit dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

c) Miraton projektprogramin vjetor dhe projektbuxhetin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, si dhe raportet vjetore për realizimin e programit të privatizimit, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

ç) Miraton dy herë në vit raportet për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit të hartuara nga drejtori ekzekutiv.

d) Përcakton formën dhe metodat e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore në tërësi të tyre, sipas degëve të ekonomisë dhe madhësisë së këtyre ndërmarrjeve.

dh) Miraton guidat, udhëzimet, kriteret dhe metodikat e hartuara nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore.

e) Përcakton vendin e ngritjes së degëve të privatizimit në rrethe.

5. Drejtori ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Drejtori ekzekutiv ka këto detyra :

- Të drejtojë dhe ekzekutojë veprimet operative të përditshme të privatizimit.

- Të organizojë dhe kontrollojë veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në përputhje me dispozitat në fuqi të privatizimit dhe me aktet e bordit drejtues.

- Përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

- Autorizon persona të tjerë për kryerjen e veprimeve të veçanta që kanë të bëjnë me privatizimin.

- Emëron shefat e degëve të privatizimit në rrethe.

6. Anëtarët e bordit drejtues, drejtori ekzekutiv, punonjësit e përcaktuar në statutin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe anëtarët e familjarë të tyre nuk lejohen të marrin pronë, aksione ose letra me vlerë të objektit që privatizohet gjatë periudhës së punësimit të tyre në këtë institucion, si dhe gjatë një viti që pason momentin e përfundimit të punësimit të tyre.

7. Drejtori ekzekutiv nuk mban pozitë ose pagë të dytë dhe nuk punon me një kontratë civile, përveç rasteve kur ai bën punë kërkimore-shkencore ose jep mësim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi